

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinstva Org. Unit	SP-02.
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	4635-2/19
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	-05-
Data. Datum Date:	23, 09, 2019
Pristina / a	




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

DATË/A:	17.09.2019
REFERENC-Ë:	19/4635/2 - 655/DMMU
PËR/ZA/TO:	"ALG" Sh.p.k Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 19/4635/2 - 655/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Pëlqim Mjedisor për eksploatimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorit në vendin e quajtur " Fusha e Tahir Beut", Pejë.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e “ALG” Sh.p.k Pejë , për Pëlqim Mjedisor për eksploatimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorit në vendin e quajtur “ Fusha e Tahir Beut”, Pejë , në pjesën e ngastrës kadastrale nr.05580-2, numri i lëndës se Çertifikatës 86009, Zona kadastrale Pejë, Komuna e Pejës


**A r s y e t i m**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë në pjesën e ngastrës kadastrale nr.05580-2, numri i lëndës se Çertifikatës 86009, Zona kadastrale Pejë, Komuna e Pejës

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM , neni 20 , është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep **Pëlqim Mjedisor**, për eksploatimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorit, nën kushtet si vijon:

- Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave te makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave;

Faqe 2 nga 5



- Të vendoset sistemi gypor për sjelljen e ujit në stabilimentet e seperimit të rëres dhe zhavorit ku lirohet pluhuri, me qëllim të zvogëlimit të sasisë së pluhurit, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të bëhet furnizimi i rregullt me ujë, që përdoret për zvogëlimin e pluhurit, nëpërmjet gypave që do të vendosën në stabilimente;
- Nëse nuk bëhet zvogëlimi i pluhurit në nivel të duhur, aplikanti duhet të vendos stabilimentet tjera depluhuese (ventilatorët me ciklona dhe filtra).
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operationale, dhe të hapet kanali për rreth fushës eksploatuese, seperacionit me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura të grumbullohen dhe orientohen në pusët sedimentuese për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngta;
- Në kohra të nxehta të bëhet stërpikja e rrugës (pjesa e pa asfaltuar), kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të materialit duhet të mbulohen me mbulesë adekuate;
- Të bëhet rikultivimi pas përfundimit të aktiviteti sipas planit të rikultivimit.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret



Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/4635/2 - ZSP/462/19 datë: 17.09.2019

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së



Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor


1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection and Waters/ Departamenti za Zaštitu Sredine i Voda

<b>DATË/A:</b>	17.09.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	19/4635/2 - 655/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit të Mjedisit dhe Ujërave
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Bazuar në kërkesën e bërë nga: "ALG" Sh.p.k Pejë me nr. prot.: 19/4635/2 - 655/DMMU, ne kemi shqyrtuar Raportin për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga ju dhe Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka vendosur sikurse ne vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1